



## Policia Finlandeze

Policia Finlandeze ruan sigurinë dhe rendin publik, parandalon dhe zbulon krimet dhe i dërgon qështjet hetimore tek një prokuror për të shqyrtuar akuzat. Policia gjithashtu e pajis popullatën me liçenca (leje) shërbimesh të ndryshme dhe është e ngarkuar për shërbimet që kanë lidhje me sendet e gjetura (e humbura).

Autoriteti i policisë dhe principet që drejtojnë punën e policisë kanë qenë përcaktuar kryesisht në ligjet e policisë, ushtrimin e forcës dhe hetimet paragjyqësore.





## Shërbimi i asistencës

Policia drejton një rrjet shërbimi në shkallë kombëtare prej rreth 280 pika shërbimesh. Disa nga këto qëndrojnë në shërbim për 24 orë, ndërsa të tjerat bëjnë një shërbim më të kufizuar, duke zënë me punë vetëm një numër të vogël punonjësish. Përveç pikave të shërbimit të policisë, shërbimet për liçencat janë të disponueshme në mbi 50 Zyrat e Qytetarëve.





## **10022**

### **– numri i urgjencës së policisë**

Në qoftë se keni një nevojë urgjente për ndihmë nga policia, thërrisni 10022 (numrin e urgjencës së policisë) ose 112 (numri i përgjithshëm i urgjencës).

Ju mund të kontaktoni me policinë personalisht, me telefon ose nëpërmjet Internetit.





## **Rendi dhe siguria publike**

Policët janë përgjegjës për mbajtjen e rendit dhe të sigurisë në vendet publike. Ata e bëjnë këtë, për shembull, duke patrulluar, duke iu përgjigjur thirrjeve urgjente, duke ruajtur sigurinë e përgatitjeve për ngjarjet e mëdha publike, duke dhënë këshilla, duke udhëzuar dhe duke ndërhyrë në aktivitete që janë të paligjshme.





## Hetimet kriminale

Hetimi paragjyqësor për një shkelje është normalisht nën përgjegjësinë e policisë lokale brenda juridiksionit në të cilin ndodh shkelja që denoncohet. Sidoqoftë, shkelja mund të denoncohet në çdo stacion policie. Stacioni i policisë pasi të marrë raportin për shkeljen, do ta dërgojë atë ku të jetë nevoja.

Policia do të fillojë hetimet paragjyqësore në qoftë se ka arsye të dyshojë nëse është bërë një krim. Jo të gjitha denoncimet e shkeljeve përfundojnë në hetime paragjyqësore.

Policia gjithashtu ka detyra të tjera hetimore përveç hetimeve paragjyqësore. Këto raste përfshijnë përcaktimin e shkaqeve të vdekjes, gjetjen e personave të humbur dhe rrethanat kur është i ndaluar ushtrimi i profesionit të biznesit.





## Shërbimet e liçencave

Shërbimet e liçencave të policisë përmbushen nga policia lokale. Pasaportat, letërnjoftimet, patentat, lejet për qytetarët e huaj dhe lejet për mbajtjen e armëve të zjarrit, përbëjnë shumicën e liçencave që lëshohen nga policia. Në lidhje me këto probleme, ai që bën kërkesën duhet të paraqitet në stacionin e policisë të paktën një herë, për t'u identifikuar personalisht nga policia. Për çdo lloj liçence duhet të paguhet një taksë.

Jashtë Finlandës, kërkesat për të vizituar vendin, kërkesat për leje pune dhe kërkesat për vizë do të jepen nga Misionet Diplomatike të Finlandës.





## Kontrolli i trafikut

Roli i policisë është të përqëndrohet për kontrollin e shpejtësisë, duke zvogëluar rastet e drejtimit të mjeteve nga personat që gjenden nën ndikimin e alkoolit dhe të substancave të tjera, duke kontrolluar përdorimin e pajisjeve siguruese dhe drejtuesit e mjeteve me rrezik të shtuar. Policia ndërhyt gjithashtu në të gjitha rastet kur ka sjellje që janë në kundërshtim me rregullat e trafikut.

Kontrolli i trafikut nga policia lokale është kryesisht në zonat urbane, ndërsa Policia Kombëtare e Trafikut përqëndrohet kryesisht në autorrugë (autostrada) dhe në rrugët e tjera kryesore.





## Sendet e gjetura

Akti i Sendeve të Gjetura (humbura) na detyron që gjetja e sendit të humbur t'i tregohet pronarit të saj ose sendet t'i dorëzohen policisë. Pronësia, blerja ose mbajtja e gjërave për të cilat është e ndaluar ose kërkohet leja e autoriteteve, si narkotikët, pijet alkoolike ilegale ose armët e zjarrit, duhet t'i dorëzohen menjëherë policisë.

Pronarët e sendeve të gjetura kanë të drejtë t'i kërkojnë ato në qoftë se i paguajnë një shpërblim gjetësit dhe ta zhdëmtojnë atë për të gjitha pagesat e rastit.

Në qoftë se pronari i sendit të gjetur nuk e kërkon pronën e tij nga policia brenda tre muajve, pronësia i kalon, përveç disa përjashtimeve, gjetësit. Në qoftë se gjetësi, gjithashtu, nuk e ushtron të drejtën e pronës që do të transferohet, brenda tre muajve, prona i kalon Shtetit.





## Organizimi

Policia ka një organizim tre-nivelesh. Në krye është Departamenti i Policisë së Ministrisë së Brendshme dhe pastaj vijnë komandat e policisë provinciale, njësitë kombëtare, institutet për stërvitjen e policisë, Qendra Teknike e Policisë, Dega IT e Administrimit të Policisë dhe nga pikëpamja funksionale Policia e Distriktit të Helsinkit.



Niveli i tretë është policia lokale, e cila nga ana administrative bie nën distriktet lokale të Shtetit. Departamentet shtetërore të distrikteve të policisë lokale veprojnë nën Komandën e Policisë së tyre Provinciale.



Informacione të tjera

[www.poliisi.fi](http://www.poliisi.fi)

[www.polis.fi](http://www.polis.fi)

[www.police.fi](http://www.police.fi)

